



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSTINA LIPJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Nr- 01-111/01-23514  
Datë: 25.05.2025

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, neni 80 dhe 81, Ligjit për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligji për Mbrojten nga Diskriminimi nr.05/2-021, Ligji për Barazi Gjinore Nr.05/L-020, Rregullores(QRK) Nr.19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Para universitar (kapitulli IV – përzgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve), Komuna e Lipjanit, shpallë:

### K O N K U R S

Institucioni: Komuna e Lipjanit;  
Drejtoria: Drejtoria e Arsimit;

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor i Institucionit Edukativo Arsimor IEAA-AP;

Vendi i punës:

1. Drejtor në SHFMU “Zenel Hajdini, në Gadime;
2. Drejtor në SHFMU “Ernest Koliqi, në Babush i Muhaxherve;
3. Drejtor në SHFMU “Vëllëzrit Domaneku, në Topliqan;
4. Drejtor në SHFMU “Dy Dëshmorët”, në Dobrajë e Madhe;
5. Drejtor në QEAP “Qerdhja”, në Lipjan;

Numri i Pozitave: Pesë (5)

Kategoria: Nëpunës i Shërbimit Publik;

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i DKA-së;

Grada/Koeficienti: Drejtor në SHFMU E14-7.20; Drejtor në QEAP E16-6.9;

Orët e punës: 40 orë në javë;

Kohëzgjatja e emërimit: Periudha kohore e kontratës zgjatë katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat në të njëjtin IEAA-AP;

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) muaj.

#### **Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë për drejtor:**

Drejtori i IEAAP ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimi dhe përditësimi i të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;

- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimitdhënësve, vlerësimin e mësimitdhënësve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimitdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimit që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit:
  - Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo - arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucion edukativo-arsimor, duke përfshirë dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

### **Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs**

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Të zotërojë të paktën njëherë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
7. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi;
8. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
9. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
10. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
11. Të ketë licencë të rregullt të mësimitdhënësit/ses sipas udhëzimit për licencim të mësimitdhënësve;
12. Të ketë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
13. Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimitdhënës/e në IEAA-AP;
14. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

*Shtetasit e huaj mund të aplikojnë kur kjo lejohet sipas legjislacionit në fuqi për zyrtarët publik.*

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit sipas pikave 7, 8, 9 dhe 10 siç parashihet te "kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs";
2. Çertifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
3. Nëse kandidati/ja ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzojë dëshminë/çertifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim sipas pikës sië parashihet te "kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs";
4. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
5. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
6. Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

7. Vërtetimin e përvojës së punës në procesin edukativo-arsimor, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
8. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
9. Dëshmi se nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
10. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në formularët e kësaj Rregulloreje.

*Për pozitat e drejtorëve të shkollave, kandidatët dorëzojnë konceptin e një plani zhvillimor të shkollës, i cili përshkruan konkretisht mënyrën dhe strategjinë përmes së cilës do të përmirësohet cilësia menaxheriale e shkollës, mësimdhënia dhe rezultatet e nxënësve të shkollës.*

**Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data 26.05.2026- 24.06.2026**

### **Mënyra e vlerësimit**

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, bëhet sipas kritereve të mëposhtme - testi me shkrim dhe intervista me gojë:

Testi me shkrim i cili përbën 50% të peshës së vlerësimit të përgjithshëm të kandidatit/es;

Në rastin e kandidatëve për drejtor të IEAA-AP, pjesë e testit me gojë/intervistës është prezentimi i konceptit të planit zhvillimor të shkollës. Në këtë rast, prezentimi i konceptit të planit zhvillimor të shkollës vlerësohet në kuadër të 30% të peshës së vlerësimit nga pjesa e testit me gojë/intervistës ndërsa portfolio profesionale vlerësohet me maksimum 20%.

Minimumi i kalueshmërisë është 70% nga përmbledhja e testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Në listë renditen vetëm kandidatët/et që kanë fituar së paku 70% të mesatares së shumës së pikëve të fituara nga testi me shkrim dhe testi me gojë/intervista.

### **Paraqitja e kërkesave për aplikim:**

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Lipjanit <https://kk.rks-gov.net/lipjan> dhe portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuar t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Lipjanit.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për çdo paqartësi aplikuesit i drejtohen Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

*Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.*

**Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore**

**Xhevahire Zeqiri**

